



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:205741

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05618117

C.nr.360/2022

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, gjyqtari Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.D., nga fshati..., komuna Skenderaj, të cilën e përfaqëson me autorizim Sh.I., avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, për kompensimin e shpenzimeve për udhëtim, ushqim gjatë punës, inflacion dhe pagë jubilarë, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të paditësit dhe pa pjesëmarrjen e të paditurës, me dt.29.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.D., nga fshati..., komuna Skenderaj.

II. DETYROHET e paditura Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur, që paditëses, D.D.:

1. në emër të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Skenderaj... për periudhën kohore dt.22.01.2021 deri me dt.21.11.2022 dhe anasjelltas duke llogaritur 70% e biletës prej 1 (një) euro, t'i paguaj paditësit për 398 ditë pune shumë prej 278.60 euro (dyqind e shtatëdhjetë e tetë euro e gjashtëdhjetë cent).

2. në emër të kompensimit për ushqimi për pranin në punë, për periudhën kohore nga dt.22.01.2021 deri me dt.21.11.2022, gjegjësisht për 398 ditë të pranisë në punë, t'i paguaj shumë prej 796 (shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) euro,

3. në emër të inflacionit t'i paguaj: për periudhën Janar-Dhjetor 2021 shumë prej 171.66 euro (njëqind e shtatëdhjetë e një euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), për periudhën Janar-Dhjetor 2022 shumë prej 585.68 euro (pesqind e tetëdhjetë e pes euro e gjashtëdhjetë e tetë cent), gjithsej inflacion shumë prej 757.34 euro (shtatëqind e pesdhjetë e shtatë euro e tridhjetë e katër cent),

4. në emër të shpërblimit jubilar për periudhen kohore 01.09.1985 deri me dt.31.08.2021 për 20 vite të përvojës së punës, për 75% të pagës bazë prej 459 euro, t'ia paguaj shumën prej 344.25 euro (treqind e katërdhjetë e katër euro e njëzet e pes cent),

- shuma e përgjithshme udhëtim, shujta, inflacion dhe pagë jubilarë është 2,176.19 euro (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e nëntëmbëdhjetë cent) me kamatë ligjore në normën prej 8%, e cila do llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë me dt.21.09.2022 deri në pagesën definitive.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë si e pabazuar në shumën prej 419.11 euro (katërqind e nëntëmbëdhjetë euro e njëmbëdhjetë cent) përtej shumës së gjykuar si në paragrafin II të këtij aktgjykimi.

IV. Obligohet e paditura Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur që paditësit, D.D., t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore: për hartimin e padisë shumën prej 104 euro, taksë për padi shumën prej 20 euro dhe për një përfaqësim shumën prej 135 euro, gjithsej shumën prej 259 euro, të cilat shuma duhet të paguhet në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja, D.D., përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, me datën 21.09.2022 pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, licensimit, inflacionit dhe pages jubilarë, për praninë në punë të paditësit në cilësinë e Mësimdhënëses në... në Skenderaj, me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses dhe të obligohet e paditura që paditëses për transport t'ia paguaj shumën prej 200 euro, për rangim shumën prej 200 euro, për inflacion shumën prej 100 euro dhe për pagë jubilarë në shumën prej 500 euro, si dhe shpenzimet e procedurës.

Ndërsa me parashtrësën e dt.28.02.2024 e bëri precizimin e padisë ashtuqë ka kërkuar të obligohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e udhëtimit në relacionin Skenderaj... dhe anasjelltas duke llogaritur 70% e biletës prej 2 euro, t'ia paguaj për 398 ditë pune shumën prej 557 euro, për shujtat ditore të cilat nuk i janë kompensuar paditësit për 398 ditë pune në shumën prej 796 euro, për inflacioni për vitin 2021, i cili ka qenë 3.4% në shumën prej 197.54 euro bazuar në pagës prej 528.20 euro dhe për vitin 2022 pasi që inflacioni ka qenë 11.6% shumën prej 648.41 euro mbi bazën e pagës prej 528.20 euro, si dhe për 75% një pagë jubilarë të papaguar për periudhen kohore 01.09.1985 deri me dt.31.08.2021 në shumën prej 396.15 euro, të cilat të drejta i takojnë në bazë të Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive të Arsimit, si dhe ka ushtruar edhe kërkesë për realizimin e kësaj të drejte, mirëpo nuk ka marrë përgjigje pozitive se në të ardhmen e paditura do ta përmbushë këtë obligim, prandaj duke i pas parasysh të lartcekurat e njëjta përmes përfaqësuesit të tij me autorizim ka ushtruar padi në këtë gjykatë.

Gjykata me aktvendim për përgjigje në padi me datë 02.02.2024, e ka detyruar të paditurën që në afat prej 15 ditësh të paraqes kundërshtimet e saj lidhur me padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

E paditura me dt.21.02.2024 ka paraqitë përgjigje në padi, në të cilën e kundërshton në tersi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, për faktin se, Kontrata Kolektive të Arsimit nr.01B/2056 e dt.18.04.2017 është shfuqizuar në bazë të nenit 47 të Kontratës së re Kolektive të Arsimit nr.01B/105 e dt.22.01.2021 dhe MASHT-i me dt.22.11.2022 është terhequr nga kjo kontratë dhe nuk gjen zbatim në kërkesën e paditësit, poashtu në bazë të nenit 341 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimit kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, andaj i propozoj gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Përfaqësuesi i palës paditëse në shqyrtim gjyqësor ka deklarua se, mbetet pranë padisë dhe precizimit të padisë duke theksuar se, me provat e dorëzuara dhe të administraura është vërtetuar se baza juridike e padisë nuk është kontestuese dhe se e paditura nuk i ka përmbushur obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive, andaj paditësja kërkon kompensimin për: shpenzimet e udhëtimit në relacionin Skenderaj... dhe anasjelltas duke llogaritur 70% e biletës prej 2 euro, t'i paguaj për 398 ditë pune shumë prej 557 euro, shujtat ditore për 398 ditë pune shumë prej 796 euro, në emër të inflacionit për vitin 2021 i cili ka qenë 3.4% shumë prej 197.54 euro duke llogaritur pagën e paditësit prej 528.20 euro, për viti 2022 inflacioni ka qenë prej 11.6% në shumë prej 648.41 euro bazuar në pagën e paditëses prej 528.20 euro, si dhe për 75% e një page jubilarë në shumë prej 396.15 euro, në shumë e përgjithshme prej 2,595.10 euro, me kamat ligjore në normën prej 8% nga dt.19.09.2019 deri në pagesën definitive.

I kërkoi shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për hartim të padis shumë prej 104 euro, për taksë për padi shumë prej 20 euro dhe për përfaqësim në një seancë shumë prej 135 euro, gjithsej shpenzime prej 259 euro.

Për palën e paditur nuk mori pjesë askush në seancën gjyqësore, nga shkresat e lëndës rezulton se e njëjta është thirrur në mënyrë të rregullt, ndërsa me parashtresën së dt.21.02.2024 e kanë njoftuar gjykatën për mospjesmarrje në seancë dhe kanë deklarua se, qendrojnë pranë përgjegjës në padi duke e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe i propozuan gjykatës që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata në bazë të nenit 423 par.4 të LPK-së seancën e shqyrtimit kryesor e mbajti pa pranin e të paditurës.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në çështjen konkrete juridike në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së i nxori dhe i administroi të gjitha provat e shënuara në procesverbalin e seancës se shqyrtimit kryesor me dt.29.02.2024 një nga një dhe të gjitha së bashku duke i krahasuar njëra me tjetrën nga të cilat rezulton se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Nga kërkesa për kompensim e dt.27.04.2022, konstatohet se paditësi iu është drejtuar të paditurës për kompensimin e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, pagës jubilarë, inflacionit dhe shujtave.

Nga përgjegjja e të paditurës e dt.06.05.2022 me numër reference 304/1, konstatohet se e paditura nuk e ka aprovuar kërkesën e paditësit për kompensimin e kërkuar.

Prej vërtetimit nr.34 të dt.15.11.2010 i lëshuar nga SHFMU... në Skenderaj konstatohet se paditësja ka qenë në mardhënie pune si Drejtoreshë në këtë institucion nga dt.01.02.2007 deri me dt.01.03.2010.

Prej vërtetimit nr.1627 të dt.09.07.2008 i lëshuar nga SHMT... në Skenderaj konstatohet se paditësja ka qenë në mardhënie pune si Mësimdhënëse e lëndës së Gjuhës Shqipe në këtë institucion nga dt.01.09.1992 deri me dt.01.0.2007.

Prej vërtetimit nr.32 të dt.09.10.2023 i lëshuar nga... në Skenderaj konstatohet se paditësja është e angazhuar në cilësinë e “Mësimdhënëses së Gjuhës Shqipe” në këtë institucion dhe nga data 22.01.2021 deri me datën 21.11.2022 i ka 398 ditë të pranisë në punë, e cila është e regjistruar në librin e të punësuarve me nr.5.

Prej vërtetimit të dt.09.10.2023 i lëshuar nga... në Skenderaj konstatohet se paditësja është e angazhuar në cilësinë e “Mësimdhënëses së Gjuhës Shqipe” në këtë institucion nga periudha 01.09.2010 deri me datën 01.09.2020 e regjistruar në librin e të punësuarve me nr.5.

Nga indeksi i harmonizimeve të çmimeve të konsumit i Agjensisë së Statistikave të Kosovës konstatohet se inflacioni për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 inflacioni ka qenë 11.6%.

Nga pasqyrëza e Buxhetit të Republikës së Kosovës konstatohet se paditësi e ka pagën bazë prej 459 euro.

Në bazë të certifikatës së vendbanimit në emër të paditësit nr.B 10526755 e dt.28.02.2024 vërtetohet fakti se paditësja vendbanimin e ka në fshatin..., komuna Skenderaj.

Në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Agjensioni Turistik... konstatohet se bileta në drejtimin Skenderaj... dhe anasjelltas është 1.00 euro.

Andaj, nga të lartëcekurat konstatohet se paditësja i ka shterrë mjetet juridike në procedurën administrative për realizimin e të drejtës së tij në kompensim.

Gjykata bazën ligjore për aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses e gjenë në Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.1B/2056 e datës 18.04.2017, respektivisht Nr.01B/105 e dt.22.01.2021, ku sa i përket të drejtës së pagesës në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në dispozitat e nenit 35 par.5 i kësaj kontrate është përcaktuar se “Punonjësve arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë iu paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, andaj gjykata bazuar në këtë dispozitë ligjore paditëses ia njohu të drejtën e pagesës në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit gjatë pranisë në punë për periudhën kohore nga dt. dt.22.01.2021 deri me dt.21.11.2022, duke llogaritur 70% të biletës prej 1 euro, që i bie të jetë 0.70 euro, për 398 ditë të pranisë në punë shumën totale prej 278.60 euro.

Sa i përket shujtave për praninë në punë se e paditura duhet t’i shpërblej paditëses shumën prej 796 euro për 398 ditë, është bazuar në dispozitat e nenit 35 par.7 të kësaj Kontrate, ku është

përcaktuar se “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune, është 2 euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk e ka obligim kompensimin për ushqim”.

Sa i përket shkallës së Inflacionit me Kontratën Kolektive të Arsimit Nr.1B/2056 e datës 18.04.2017 respektivisht Kontratës Nr.01B/105 e dt.22.01.2021, në nenin 35 par.10 është përcaktuar se “Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, ku gjykata bazuar në listat e pagës nuk rezulton se shkalla e inflacionit është futur në pagë, andaj sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me shkallën e inflacionit e ka bazuar në të dhëna zyrtare të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës përmes web faqes zyrtare.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2021, gjykata e ka marr për bazë shkallën mesatare e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj sa i përket periudhës së vitit 2021, gjykata ia njohu paditëses shumën prej 171.66 euro, duke marrë për bazë që paditëses pagën bazë e kishte prej 459 euro, ndërsa për periudhën Janar-Dhjetor 2022, gjykata e ka marr për bazë shkalla mesatare e inflacionit e cila ka qenë 11.6%, andaj sa i përket periudhës së vitit 2022 gjykata ia ka njohur paditëses shumën prej 585.68 euro, duke marrë për bazë që paditësi pagën bazë e kishte prej 459 euro, i cili kërkoj kompensimin në inflacion për 11 muaj për secilin vit.

Ndërsa sa i përket shpërblimit jubilar në dispozitat e nenit 35 par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.1B/2056 e datës 18.04.2017, respektivisht Nr.01B/105 e dt.22.01.2021 shprehimisht është e përcaktuar se “Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerën... ”: par.8.2 “për 20 vjet të përvojës se punës në vlerë të 75% të një pagë bazë”, andaj në bazë të kësaj dispozite gjykata ia njohi paditëses këtë të drejtë në shumën prej 344.25 euro, bazuar në pagën bazë të paditëses prej 459 euro.

Gjykata në bazë të provave të administruara vërtetoi se kërkesëpadia e paditëses është e mbështetur në prova faktike të parashtruara me padi si dhe në Kontratën Kolektive të Arsimit dhe në Ligjin e Punës. Më rastin e vendosjes së çështjes konkrete juridike gjykata mori për bazë faktin se e paditura në bazë të dispozitave të nenit 37 të Kontratës Kolektive të Arsimit ka qenë e obliguar që vullnetarisht ta përmbush detyrimin ndaj të punësuarve që i plotësojnë kushtet sipas kontratës se lartpërmendur, por këtë obligim nuk e ka përmbushur, andaj paditësi me të drejtë ka kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Në rastin konkret gjykata i zbatoj dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L/212 ku shprehimisht thuhet “Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshje të tillë kolektive”.

Gjykata i vlerësoi të gjitha kundërshtimet e palës së paditur të paraqitura me përgjigje në padi te cilat kanë të bëjnë me pretendimin se e drejta e paditësit për kompensim është parashkuar sipas nenit 341 të LMD-së, por këto pretendime të palës se paditur për gjykatën janë të pabazuara për faktin se, sipas dispozitave të nenit 87 të Ligjit të Punës ku është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat

nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, e që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim për faktin se, paditësi ka ushtruar padinë në gjykatë me dt.21.09.2022 ku edhe është ndalë periudha e parashkrimit, prandaj ky pretendim i të paditurës dhe pretendimet tjera nuk qenë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në dispozitat e nenit 245 të LMD është përcaktuar se “Kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj Gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Është refuzuar pjesa e kërkesëpadisë të paditëses mbi shumat e gjykuara si në dispozitivin III të këtij aktgjykimit sa i përket inflacionit për vitin 2021 dhe 2022 në shumën prej 88.60 euro dhe për pagë jubilarë në shumën prej 51.90 euro pasi që gjykata me rastin e vendosjes e ka marrë për bazë llogaritjen e pagës bazë të paditësit prej 459 euro, ndërsa sa i përket shpenzimeve për udhëtimi gjykata e refuzoj shumën prej 278.60 euro, pasi që në shkresat në lëndë, respektivisht vërtetimit të lëshuar nga Agjensioni Turistik “Memi Reisen” konstatohet se çmimi i biletës Skenderaj – Rakinice dhe anasjelltas është 1.00 euro, andaj me rastin e vendosjes është marrë për bazë 70% i çmimit prej 1.00 euro.

Gjykata sa i përket kamatës ligjore në normën prej 8%, është i bazuar në dispozitat e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD nr. 04/L-077 dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 356/2020 te datës 07/12/2022.

Vendimi që pala e paditur t’i bartë shpenzimet procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 259 euro është i bazuar në dispozitat e nenit 449, 452 par.1 të LPK-së si dhe në Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18.03.2017.

Me sa u tha më lartë konform dispozitat të nenit 143, 476 dhe 477 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.360/2022, me dt.29.02.2024

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.